



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 835/27 Prot.

Tiranë, më 21/12/2018

**V E N D I M**

**Nr. 240, Datë 21/12/2018**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË TATIMEVE TIRANË**  
**“MBI PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE”**  
**për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit për auditimin e ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm; duke konsideruar se pavarsisht përpjekjeve, kjo drejtori me peshë të rëndësishme në planin kombëtar nuk ka arritur të përmbushë pritshmëritë lidhur me, mbledhjen e të ardhurave nga tatimet dhe taksat kombëtare, monitorimin me efikasitet dhe korrigjimin e rasteve të moszbatimit të legjislacionit tatimor, mirë funksionimin e tre prej drejtorive kryesore të saj, ezaurimimin e plotë dhe në afat të masave shtrënguese për detyrimet e papaguara, si dhe të garantojë përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi në tërësi për mbledhjen me efektivitetin e duhur të detyrimeve tatimore dhe angazhimin e duhur kundër evazionit fiskal dhe paligjshmërisë, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**VENDOSA:**

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për, Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë Financiare” të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, sipas programit të auditimit nr. 835/1 prot. datë 26.07.2018, i ndryshuar me shkresën nr. 835/2 prot. datë 07.09.2018 dhe nr. 835/3 prot. datë 25.09.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.
- II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

## KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare, i ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë (DRT Tiranë), sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), për vitet 2016-2017 janë konstatuar mangësi dhe parregullsi sa i përket zbatimit të planit të të ardhurave tatimore, në funksionimin e drejtorive në DRT, mungesën e planeve dhe analizave mujore dhe vjetore, si dhe aspekte të tjera të mangëta të cilat e kanë ekspozuar njësinë drejt një risku në administrimin dhe monitorimin e tatimpaguesve dhe përkatësisht: Mungojnë të dhënat dhe informacionet për vitin 2016 nga Drejtoria e Vlerësimit dhe Kontabilitetit të të Ardhurave si dhe Sektorit të Kontrollit nga Zyra për vitin 2017.

Konstatohen diferenca të konsiderueshme mospërputhjes për periudhën nën auditim në të dhënat e deklaratës së Tatimit mbi Fitimin (TF) dhe Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin (TFTH) krahasuar kjo me situatën financiare të shitjeve të tatueshme në Tatimin mbi Vlerë e Shtuar (TVSH) të paevidentuara nga ana e kësaj administrate, të cilat kanë sjellë vlera të munguara detyrimesh për llojet e tatimeve të sipërcituar, me efekt të drejtpërdrejtë në realizimin e të ardhurave tatimore. Mungesa e monitorimit në kohë të situatës financiare të tatimpaguesve me të ardhura të realizuara mbi 5 milion lekë dhe mbi 8 milion lekë ka sjellë si rrjedhojë mos ndryshimin e përgjegjësisë tatimore respektivisht të TVSH dhe Tatimit mbi Fitimin.

Mangësi dhe parregullsi evidentohen në procedurat e planifikimit dhe kryerjes së kontrolleve tatimore dhe më konkretisht në, planifikimin nga përgjegjësit e sektorit operacional të orëve në dispozicion të inspektorëve në planin e muajit pasardhës, zbatimin e pikave të programit të kontrollit, analizat e kostos së mallrave të shitur dhe tepricave kreditore, klasifikimin e blerjeve sipas natyrës së aktivitetit dhe trajtimin e tyre, trajtimin e inventarëve kontabël të periudhave të mëparshme si inventarë fizikë, në aktet e njoftimit të detyrimit të kontrollit, në miratimin dhe nënshkrimin e praktikës nga hallkat mbikëqyrëse, trajtimin e transaksioneve me lekë në dorë (*në Cash*) mbi kufijtë e përcaktuar ligjorë, trajtimin e përkatësisë së ambienteve ku ushtrohet aktiviteti dhe për kontratat e qirasë të lidhura verifikimi i tatimit në burim të llogaritur dhe aplikimi i përcaktimeve të VKM përkatëse etj.

Borxhi tatimor në këtë DRT, pavarsisht efekteve në ulje gjatë vitit 2017 si rezultat i aplikimit të ligjit nr. 33/2017 datë 30.03.2017 "Për pagesën dhe Fshirjen/Shuarjen e detyrimeve tatimore", ka një trend rritës të pandalshëm. Problematika paraqiten në subjektet me status "Pasiv" apo "Kërkesë për çregjistrim", por dhe tatimpaguesve të tjerë, detyrimet e të cilëve kapin një vlerë të konsiderueshme. Masat shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve të papaguara ndaj administratës tatimore nuk ezaurohen në mënyrë të plotë, sipas përcaktimeve ligjore të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" përkatësisht, neni 93, "Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë", neni 94, "Urdhri i sekuestrimit", neni 95 "Pasuria, objekti sekuestrimit", neni 96 "Shitja e pasurisë së sekuestruar", neni 97 "Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë". Mos ezaurimi i hapave të mësipërm sipas ligjit, sidomos për tatimpagues që mbartin një borxh në vlerë të lartë, sjell risk në rritje në mbledhjen e detyrimeve të papaguara.

Po kështu, vakancat për staf definitiv në dy drejtoritë kryesore të DRT Tiranë, Drejtorinë e Kontrollit Tatimor dhe atë të Mbledhjes me Forcë për një periudhë të gjatë dhe plotësimi i këtyre funksioneve të përhershëm në disa raste me punonjës me kompetencë të deleguar në mënyrë të paargumentuar, ka ndikuar negativisht në ecurinë, cilësinë dhe realizimin e detyrave të tyre.

Veç mangësive organizative dhe funksionale në total vlera e parregullsive financiare të konstatuara në DRT Tiranë arrin vlerën **22.8 miliard lekë**, e cila mungon aktualisht në buxhet në zërin e të ardhurave tatimore apo llogaritë e arkëtueshme të shtetit.

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1.-Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse përcjellë me shkresën e KLSH-së me nr. 546/21, datë 28.09.2016 dhe protokolluar në DRT Tiranë me nr. 33392/40 prot, datë 27.10.2016. Nga **34 rekomandime** të lëna janë zbatuar 10 rekomandime ose 29 % e tyre, janë në proces zbatimi 6 rekomandime ose 18 % dhe nuk janë zbatuar 18 rekomandime ose 53 % e tyre. Duke analizuar rekomandimet sipas natyrës së tyre, nga **5 masa organizative** për përmirësimin e gjendjes janë zbatuar 3 rekomandime, 1 masë është në proces dhe 1 masë rezultoi e pazbatuar, nga **8 rekomandime për shpërblim dëmi** në vlerë totale 464,474,184 lekë, janë në proces 5 rekomandime në vlerën 188,859,491 lekë dhe janë të pazbatuara 3 rekomandime në vlerën 275,614,703 lekë, nga **21 rekomandime për masa disiplinore** janë zbatuar 7 masa disiplinore dhe 14 masa disiplinore të cilat megjithëse nisur nga DRT Tiranë ato kanë mbetur të pazbatuara nga ana e DPT. *Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr.1 faqet nr15 - 24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1 Rekomandimi:** DRT Tiranë, të analizojë rekomandimet e pa zbatuara duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete për moszbatimin e tyre si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për kontabilizimin e vlerës prej 275,614,703 lekë rekomanduar në Raportin e mëparshëm të KLSH dhe anekseve përkatëse, përcjellë me shkresën nr. 546/21, datë 28.09.2016 dhe regjistruar në DRT Tiranë me nr. 33392/40 prot, datë 27.10.2016.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në DRT Tiranë konstatohen mangësi në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e punonjësve të monitorimit nga zyra të tatimpaguesve dhe konkretisht të (Ish) Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit për vitin 2016 sipas strukturës së mëparshme dhe Sektorit të Kontrollit nga Zyra pjesë e Drejtorisë së Kontrollit për vitin ushtrimor 2017 sipas strukturës ekzistuese. Këto mangësi evidentohen kryesisht në, keq menaxhimin e burimeve njerëzore për arritjen e objektivave nga hallkat mbikëqyrëse konkretisht, përgjegjësit e sektorit dhe drejtori i drejtorisë ku përmendim, mungesën e planeve operacional vjetorë por dhe atyre mujorë të punës, mungesën e ndarjes së punëve për secilin punonjës, monitorimin e realizimit të detyrave të përcaktuara, mbikëqyrjen e deklaratave dhe ecurinë e pagesave të tatimpaguesve, bashkërendimin e punëve me sektorë të tjerë etj, dhe bien ndesh me detyrat specifike të këtyre funksioneve parashikuar në rregulloren nr. 8801/1 prot. datë 04.10.2010 si dhe nenit 22 dhe 25 të rregullores “Për funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore” miratuar me urdhrin nr. 19 datë 22.02.2017 të Ministrisë së Financave. Mos përmbushja e detyrave ka krijuar një situatë problematike lidhur me monitorimin nga zyra të tatimpaguesve, analizën e treguesve fiskalë të vetëdeklaruar nga tatimpaguesit, dhe dokumentimin e situatës financiare të tatimpaguesve për të dy periudhat ushtrimore në auditim 2016 dhe 2017 duke krijuar kaos në këtë Drejtori Rajonale e cila administron një numër të konsiderueshëm tatimpaguesish me qarkullim të lartë dhe zë një peshë të rëndësishme në mbledhjen e të ardhurave tatimore në rang kombëtar. *Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr.3 faqet nr. 47 -150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1 Rekomandimi:** DRT Tiranë, të hartoj dhe miratoj çdo fillim viti dhe muaji planet e punës për sektorët e Drejtorisë së Kontrollit me detyra të mirë specifikuar sipas funksioneve përkatëse dhe me afate të mirë përcaktuara, në mënyrë që, detyrat e ngarkuara të jenë të matshme për secilin pozicion, të dalin qartë problematikat e pazezuruara dhe të evidentohen përgjegjësitë përkatëse.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit sipas përcaktimeve të nenit 12 të Rregullores së funksionimit ka të parashikuara një sërë detyrash të rëndësishme në funksion të veprimtarisë së DRT ku disa prej tyre janë;

*-harton raporte sasiore dhe cilësore për veprimtarinë e tatimpaguesve si dhe për planin operacional të drejtorisë sipas analizës përkatëse,*

*-vlerëson risqet e mospërbushjes tatimore,*

*-përcakton tatimpaguesit për kontroll në bashkëpunim me drejtorinë e kontrollit tatimor,*

*-planifikon dhe shpërndan listën e tatimpaguesve për analizën financiare dhe fiskale,*

*-kryen analizën e riskut të tatimpaguesve,*

*-dërgon planet e kontrollit mbi bazë risku krijon databazë me analizat e kryera duke standartizuar punën dhe procedurën etj.*

Për këtë sektor në organikën e miratuar janë parashikuar 10 inspektorë dhe një përgjegjës. Pavarsisht rëndësisë situata në fakt paraqitet krejt ndryshe, ku detyrat e kryesore të përcaktuara efektivisht nuk përmbushen. Mungon bashkëveprimi i saj me drejtorinë e kontrollit tatimor, megjithëse detyra bazë është furnizimi me analiza të detajuara duke dhënë dhe propozimet përkatëse drejt kësaj drejtorie lidhur me analizat përkatëse, propozimet për kontroll etj. Detyrat e hartimit dhe përditësimit të evidencave të realizimit të treguesve sipas rregullores janë detyrë e sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit por në fakt këto evidenca hartohen dhe përpunohen prej Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit. Pas ndryshimeve në strukturën e administratës tatimore në fillim vitin 2017, analizat dhe informacionet e viteve të mëparshme në nivel tatimpaguesi nuk disponohen prej saj, duke bërë që ato të mos shfrytëzohen për periudhat në vijim. Projektioni për këtë sektor sipas rregullores përkatëse paraqet formën e një strukture risku, e cila në rastin konkret nuk rezulton. Për vitin 2017, në të cilën ka operuar struktura e re veprimtaria e saj nuk paraqet përputhshmëri me kuadrin rregullator në fuqi dhe efektivitetin e një strukture të fokusuar. *Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr.3 faqet nr. 47-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**3.1- Rekomandimi:** DRT Tiranë, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e detyrave të përcaktuara në rregulloren "Për Funksionimin e Drejtorive Rajonale", për Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit, dhe rritjen e bashkëpunimit midis këtij sektori dhe Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, 10 nga 22 praktika kontrolli të audituara evidentohen tejkalime afatesh të cilat shkojnë nga 30 ditë deri 300 ditë duke marrë si pikë nisje momentin e kryerjes së njoftimit për kontroll tatimor konceptuar nga përgjegjësi dhe miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit. Konkretisht tejkalime rezultuan në këto praktikë e kontrollit për tatimpaguesit: I..... me NIPT L....., A.....me NIPT K....., A.....me NIPT L....., L.....me NIPT K....., S.....me NIPT L....., E... me NIPT K....., E.....me NIPT L....., B.... me NIPT K....., S.....me NIPT L..... Në disa prej praktikave të kontrollit si rimbursim TVSH-je, ndërtim, prodhim, etj me qarkullim të lartë vjetor grupet e kontrollit përbëhen vetëm nga një inspektor kontrolli. Po kështu mungojnë evidencat e ngarkesës së orëve për çdo inspektor gjatë vitit e cila ndikon në programimin e kontrolleve në vijimësi, çka paraqet nevojën për qasje më të kujdesshme në këtë drejtim nga ana e drejtuesve të DRT. *Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr.3 faqet nr. 47-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**4.1- Rekomandimi:** Drejtoria e Kontrollit në DRT-Tiranë, të mirë programojë dhe të zbatojë me korrektësi planet e punës të miratuar nga DPT për përfundimin në afat të kontrolleve. Të tregohet kujdes në programimin e pikave për trajtim, orëve për inspektor kontrolli, llojin e tatimeve të përfshira dhe datën e nisjes së kontrollit. Në rastet e kontrollit të tatimpaguesve me qarkullim të konsiderueshëm, vlera të larta kërkesash për rimbursim apo aktivitete me natyrë komplekse, grupet e kontrollit të kenë në përbërje të paktën 2 (dy) inspektorë.

**5.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga DRT-Tiranë, nga 8,384 tatimpagues aktivë klasifikuar si Bisnes i Madh të cilët janë të regjistruar nën përgjegjësinë e Tatimit mbi Fitimin, 714 prej tyre ose rreth 9% e numrit gjithsej deklarojnë humbje vjetore *për tre vite rresht*. Sipas treguesve *Të ardhurat dhe Shpenzimet* në deklaratën e Tatimit mbi Fitimin për vitin 2016 dhe deklaratave të viteve respektive 2014 dhe 2015 për këta tatimpagues, rezulton se humbja e vetëdeklaruar arrin vlerën e 62,103,107 mijë lekë. Nga kjo vlerë si rrjedhje e vlerësimeve tatimore kemi një ulje prej 14,791,328 lekë. Në përfundim për 714 tatimpaguesit të cilët janë renditur në aneksin nr. 3.9 pjesë e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi humbja shkon në *47,311,779 mijë lekë*. Për këta tatimpagues të cilët rezultojnë me humbje 3 vite rresht konkretisht për vitet 2014-2015-2016, DRT Tiranë nuk ka kërkuar në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit në kundërshtim me nenin 104 “Fillimi i procedurave të falimentimit”, të Ligjit 9920, dt 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe dispozitave të nenit 14 të Ligjit nr. 8901 datë 23.05.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar. Këto dispozita përcaktojnë se administrata tatimore kërkon fillimin e procedurës së falimentimit për tatimpaguesit, shoqëri tregtare që deklarojnë me humbje të kapitaleve të veta për të paktën 3 vite rresht. Në çdo rast DRT ka detyrimin të kryej verifikimet e nevojshme dhe të kërkoj në gjykatë fillimin procedurës kundrejt një tatimpaguesi nëse ai plotëson kushtet e parashikuara për falimentim. Mos fillimi i procedurës për këta tatimpagues përbën mangësi të theksuar kryerjen e detyrave funksionale nga punonjësit e ngarkuar të DRT Tiranë. *Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr.3 faqet nr. 47-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**5.1- Rekomandimi:** DRT Tiranë, të kryej analizat dhe verifikimet e nevojshme për humbjet e deklaruara dhe në rastet e përmbushjes së kushteve ligjore, të kërkojë në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit për tatimpaguesit cituar në aneksin nr. 3.9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe të nxjerrë përgjegjësitë individuale për moskryerjen e veprimeve në kohë.

*Brenda 31.01.2019*

**6.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, pas ndryshimeve strukturore të ndodhura në organizimin dhe funksionimin e administratës tatimore, sipas Urdhër të Kryeministrit **nr.126, datë 02.08.2016**, “Për Miratimin e Strukturës Organizative dhe të Numrit të Përgjithshëm të Personelit të Administratës Tatimore” struktura e Verifikimit në Terren si në të gjitha Drejtoritë Rajonale është shkrië dhe detyrat e saj funksionale sipas strukturës së re i janë adresuar Sektorit të Zbatimit pjesë e Drejtorisë së Hetimit Tatimor. Nga përpunimi i bazës së të dhënave të vëna në dispozicion prej DRT-Tiranë mbi numrin e tatimpaguesve mosdeklarues sipas periudhave vërehet se për periudhën Janar-Korrik të vitit 2016 në të cilën ka operuar struktura e “Verifikimit në Terren” numri i tyre arrin në 2,627, ndërkohë për të njëjtën periudhë të vitit 2017 ky numër shkon në 3,862 tatimpagues. Pra numri i mos deklaruesve në një hark të shkurtër kohor është rritur me 1,235 të tillë apo rreth 50% të shifrës së një viti më parë. Kjo rritje e pa analizuar dhe argumentuar nëpërmjet verifikimeve në vendndodhjen e këtyre tatimpaguesve, në vlerësimin tonë përbën një “kambanë alarmi” për administratën tatimore në DRT-Tiranë por dhe strukturën drejtuese në DPT e cila mbikëqyr punën e DRT-ve në vijimësi. Sektori i Zbatimit i cili kryen verifikimet në terren megjithëse është pjesë e strukturës së DRT-Tiranë në fakt ka në mbikëqyrje një hapësirë territoriale më të gjerë se DRT-Tiranë kjo sipas udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24 datë 02.09.2008, i ndryshuar, sipas të cilit kjo strukturë mbulon Rajonin Qendror i cili përfshin dhe DRT të tjera njëkohësisht. Po kështu nëse do të shohim bashkëveprimin shkresor midis Sektorit të Zbatimit (Rajonal) dhe atij të Kontrollit nga Zyra në DRT-Tiranë ky bashkëveprim paraqitet thajse inekzistent duke krijuar një “risk të lartë” i cili cënon mirë funksionimin dhe administrimin tatimor pasi krijon shikëputje të aktivitetit monitorues nga zyra nga ai i verifikimit në vendndodhjen e

tatimpaguesit. Këta elementë por jo vetëm, paraqesin nevojën për rishikimin e kësaj hallke operacionale mjaft të rëndësishme të administratës tatimore, për kryerjen e një analize të thelluar bazuar në rezultate konkrete sa i përket efikasitetit dhe efektivitetit të strukturës aktuale të “Sektorit të Zbatimit” dhe krahasimin me strukturën e mëparshme të “Verifikimit në Terren” për nxjerrjen e përfundimeve dhe adresimin e situatës drejt instancave përkatëse. Problematik vijon të mbetet fakti që punonjësit e “Sektorit të Zbatimit” megjithëse kryejnë të njëjtat funksione me ata të strukturës paraardhëse nuk janë pjesë e trupës së nëpunësve civilë. KLSH në auditimet e ushtruara në DPT për vitet 2016 dhe 2017, ka mbajtur qëndrime të artikuluar lidhur me mënyrën dhe formën e organizimit të strukturës së Hetimit Tatimor në tërësi si dhe përfshirjen në trupën e nëpunësve civilë të punonjësve të Sektorit të Zbatimit e cila vijon të mbetet një problematikë e pazgjidhur. *Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr. 5 faqet nr.164 -168, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**6.1-Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të ngrejë një grup pune me punonjësit më me eksperiencë të administratës tatimore në DPT, i cili të kryej një analizë krahasuese profesionale në nivel kombëtar, mbi bazë treguesish faktik, për periudhën 2015-2016 në të cilën ka qenë në funksion *Sektori i Verifikimit në Terren*, duke i krahasuar me treguesit e periudhës 2017-2018 në të cilën ka operuar *Sektori i Zbatimit*, lidhur me numrin e tatimpaguesve të kontrolluar, fushës së shkeljeve të konstatuara, vlerës së penaliteteve të vendosura, burimeve njerëzore të përdorura, si dhe kritereve të tjera të qënësishme. Mbi bazën e këtij konkluzioni të bëhen propozimet përkatëse në Ministrinë e Financave dhe e Ekonomisë për këtë strukturë.

*Brenda 28.02.2019*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë u konstatua se, mungesa Drejtorit të Drejtorisë për një periudhë të gjatë, mosplotësimi i vendeve vakante, në nivel përgjegjësi dhe specialistësh për këtë Drejtori, mungesa e planeve operacionale vjetore dhe mujore të Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë ka sjellë mangësi të cilat kanë ndikuar negativisht në ecurinë, cilësinë dhe realizimin e detyrave të përcaktuara. Pozicioni i Drejtorit në këtë Drejtori është plotësuar me delegim kompetencash dhe aktualisht funksionon i tillë dhe jo me emërim të përhershëm. Mbi bazën e treguesve vjetorë vënë dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se, nga krahasimi i vlerës së borxhit të datës 01 Janar 2016 i cili kap vlerën prej 24 miliard lekë dhe atij të datës 31 dhjetor 2017 në vlerën 40.4 miliard lekë, evidentohet një rritje prej 16.4 miliard lekë. Nëse kjo vlerë borxhi do të zhvishet nga efekti i zbatimit të ligjit të faljes nr. 33/2017 datë 30.03.2017, rritja arrin vlerën prej 33.3 miliard lekë ose 138.7 % krahasuar me fillim vitin 2016. Gjatë periudhës nën auditim evidentohen mangësi në ezaurimin e plotë të masave shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve të papaguara ndaj administratës tatimore, në kundërshtim kjo me përcaktimeve ligjore në nenin 93, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë”, neni 94, “Urdhri i sekuestrimit”, neni 95 “Pasuria, objekti sekuestrimit”, neni 96 “Shitja e pasurisë së sekuestruar”, neni 97 “Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë” ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr. 4 faqet nr. 150 -163, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**7.1-Rekomandimi:** DRT Tiranë të kryej një analizë të thelluar të situatës dhe për tatimpaguesit në statusin Aktiv dhe atë Pasiv, të cilët kanë detyrime në vlera të larta ndaj administratës tatimore, të identifikojë asetet e tyre, llogaritë bankare, pasuri të luajtshme e të paluajtshme, mjete transporti etj dhe të vazhdojë procedurat në marrjen e masave shtrënguese si: “*Urdhër Sekuestrimi e Konfiskimi*” deri në nxjerrjen në ankand të pasurisë e aseteve, me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore të papaguara për llogari të administratës tatimore, të pakryera deri tani.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7.2-Rekomandimi:** DRT Tiranë të hartojë plane operacionale vjetore dhe mujore si dhe të për ndjek me rigorozitet masat në nivel tatimpaguesi. Të intensifikohet bashkëpunimi me struktura të tjera të administratës tatimore dhe kryesisht me drejtorinë e Hetimit Tatimor për mbledhjen e borxhit tatimor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8.-Gjetje nga auditimi.** Në vërtetimet e përzgjedhura (417 vërtetime rastësore të muajve: dhjetor 2016, janar, prill, maj, tetor, dhjetor të vitit 2017, lëshuar 200 tatimpaguesve) rezultoi se, rreth 23% e vërtetimeve të përzgjedhura janë lëshuar mbi afatin 2 ditor të përcaktuar për to në Rregulloren nr. 3 datë 11.10.2010 “Për ofrimin e asistencës dhe shërbimeve për Tatimpaguesit e regjistruar dhe individët nga funksioni i shërbimit të tatimpaguesve në DRT”, Pikat 9.1, 9.2, 9.7. Prej hyrjes në fuqi më 07.09.2017, të marrëveshjes së bashkëpunimit midis DPT dhe ISSH, për lëshimin e vërtetimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për individët punëmarrës, vonesat e konstatuara në lëshimin e vërtetimeve janë ulur në 14%.

Në vërtetimet me nr/ prot. 29713, 29713/1, 29713/2 datë 30.05.2017 lëshuar subjektit ‘A.....me NIPT K....., me nr/prot. 29737, 29737/1, 29737/2 datë 30.05.2017 lëshuar subjektit ‘S.....me NIPT L....., me nr/prot. 30112, 30112/1, 30112/2 lëshuar subjektit ‘N....’ me NIPT J....., nr. 35016, 35016/1, 35016/2 datë 21.12.2016 lëshuar subjektit ‘O....’ me NIPT K..... për pjesëmarrje në tender, u konstatua miratim i tyre nga Drejtori i mëparshëm Z. E.G, i cili në këtë datë është deleguar në Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë, duke humbur kompetencën e firmës për vërtetimet e DSHT dhe duke sjellë pavlefshmëri të tyre, të cilat sipas dijeninë tonë deri në fund të auditimit, kanë qenë pa pasoja procedurale administrative. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Kodin e Procedurave Administrative, Neni 32 ‘Përfundimi i delegimit’, ... ‘*Delegimi i kompetencave përfundon b) me mbarimin e detyrave*’ dhe Neni 31 ‘*Kompetencat e organit delegues*’, Pika 2... ‘*Organi delegues ka të drejtë të rimarrë kompetencat e deleguara, si dhe të revokojë çdo akt apo veprim të ndërmarrë nga organet e deleguara në kundërshtim me dispozitat për vlefshmërinë e akteve administrative të parashikuara nga ky Kod*’. *Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr. 2 në faqet nr. 24-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**8.1-Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të marrë masa për ruajtjen e vlefshmërisë së vërtetimeve të lëshuara prej saj, në kushtet e ndryshimit të kompetencave të autoritetit më të lartë lëshues të tyre, në funksion të mbrojtjes dhe transparencës ndaj tatimpaguesit.

*Në vijimësi*

**9.-Gjetje nga auditimi:** Nga krahasimi i kërkesave për çregjistrim dhe subjekteve të çregjistruara faktikisht rezultoi se, për aplikimet e reja të vitit 2016 vetëm 2% e tyre kanë arritur të çregjistrohen brenda vitit nga ana e DRT Tiranë dhe kanë mbetur pa çregjistruar 4,236 subjekte, ndërsa në mënyrë progresive për vitin 2016 (të cilat mbartin numrin e subjekteve që kanë aplikuar deri në 31.12.2016 dhe nuk kanë mundur të çregjistrohen ende nga DTR) rezulton se 60% e tyre janë çregjistruar. Për vitin 2017 kanë aplikuar për çregjistrim 4,324 subjekte dhe konstatohet përmirësim në procesit të çregjistrimit për faktin se, prej ligjit të faljes, në fund të vitit 2017 kanë mundur të çregjistrohen në DTR 7,723 subjekte me detyrime tatimore të falura, janë çregjistruar gjithsej 10,079 subjekte dhe kanë mbetur pa çregjistruar 1,968 subjekte. Nga Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve (DSHT), megjithëse ekziston një marrëveshje bashkëpunimi midis DPT dhe QKB për shkëmbimin e ndërsjelltë të të dhënave, nuk mund të evidentohet numri i subjekteve të çregjistruar prej QKB përgjatë vitit 2016 dhe 2017. Mungesa e një evidence të tillë nxjerr në pah problematikë në transmetimin e të dhënave të regjistrimit tregtar midis dy institucioneve, i cili rrit riskun në çregjistrimin e subjekteve nga QKB, pas marrjes ose jo të konfirmimit përkatës nga DTR dhe në spastrimin e regjistrimit nga subjekte të çregjistruar nga QKB dhe ende te regjistruar

në DRT. Çregjistrimi i tatimpaguesve bazuar nga problemet e dërguara nga DRT mbetet një proces i vështirë, pasi finalizimi i çregjistrimit për shumë raste, nuk mund të kryhet dhe të pasqyrohet normalisht në regjistrin e DRT. (Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr. 2 në faqet nr. 24-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1-Rekomandimi:** DRT Tiranë të marri masa të mëtejshme në drejtim të përmirësimit të procesit të çregjistrimit, transmetimit e pasqyrimit final të tij në regjistrin e DRT, marrjes së plotë të të dhënave nga QKB dhe evidentimit të rasteve të mundshme të mospërputhjes së çregjistrimeve midis dy institucioneve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **C.2 MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICËNCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, DRT-Tiranë nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e detyrimit tatimor nëpërmjet kontrollit tatimor në vend apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit të cilët rezultojnë me deklarimit të pasaktë të deklaratës së Tatimit mbi Fitimin (TF), Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin (TFTH) dhe Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), në kundërshtim me përcaktimet ligjore në nenin 68, 71 dhe 72 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe akteve të tjerë nënligjorë të cilët rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe më konkretisht;

a) U konstatuan diferenca pozitive dhe negative të konsiderueshme në qarkullimin e të ardhurave të deklaruar në formularin vjetor të **TF** me të totalin e shitjeve të vetëdeklaruar nëpërmjet deklarave të TVSH-së sipas situatës financiare për periudhat 2016-2017. Përkatësisht **925 tatimpagues BM** kanë deklaruar më pak të ardhura të tatueshme në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit 2016 në shumën **18,900,557 mijë lekë** krahasuar me qarkullimin total të situatës financiare për të njëtin vit, ndërsa **969 tatimpagues** kanë deklaruar më pak të ardhura të tatueshme në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit 2017 në shumën **22,670,876 mijë lekë** krahasuar me qarkullimin total të situatës financiare për të njëtin vit duke sjellë një vlerë të munguar në zërin Tatim Fitimi në vlerën 6,235,715 mijë lekë. ( 41,571,433 mijë lekë x 15%)

b) Për vitet 2016 dhe 2017 në deklaratën përfundimtare të Tatim Fitimit u konstatuan subjekte mosdeklarues të të ardhurave, përkatësisht për 2016 janë **667 mosdeklarues** me një vlerë transaksionesh **15,362,650 mijë lekë** ndërsa për 2017 janë **315 mosdeklarues** të deklaratës përfundimtare të TF 2017 me një shumë transaksionesh prej **55,946,165 mijë lekë**, të cilat kanë sjellë një efekt të munguar në këtë tatim në vlerën 10,696,322 mijë lekë. ( 71,308,815 mijë lekë x 15%).

c) Në deklaratat vjetore të TF për vitin 2016 u konstatuan **1,465 subjekte** të cilët kanë deklaruar të ardhura më shumë në këtë deklaratë krahasuar me shitjet e deklaruar në situatën financiare të këtij viti, në shumën **14,756,857 mijë lekë**, ndërsa për vitin 2017 u konstatuan **1,145 subjekte** të cilët kanë deklaruar të ardhura të tatueshme më shumë në vlerën **9,521,125 mijë lekë** krahasuar me shitjet e deklaruar sipas situatës financiare vjetore. Këto diferenca sjellin një vlerë të munguar të TVSH-së në vlerën 4,855,596 mijë lekë. ( 24,277,982 mijë lekë x 20%).

d) Për periudhën ushtrimore vitet 2016 dhe 2017 në një grup tatimpaguesish subjekte të biznesit të vogël me tvsh, pjesë e fashës me qarkullim 5-8 milion lekë, u konstatuan raste të mosdeklarimit të deklaratës përfundimtare të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin, megjithëse kanë kryer transaksione gjatë dhe përkatësisht për vitin 2016 janë konstatuar **697 mosdeklarues** më një vlerë prej



**4,146,635 mijë lekë** ndërsa për vitin 2017 janë konstatuar **1,198 mosdeklarues** me një vlerë prej **7,407,506 mijë lekë**. Këto mosdeklarime kanë sjellë një vlerë të munguar për këtë tatim në vlerën 577,707 mijë lekë. (11,554,141 mijë lekë x 5%). Në total vlera e parregullsive financiare të pavidentuara nga administrata tatimore arrin shumën e **22,365,340 mijë lekë**. *Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr.3 faqet nr. 47-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1-Rekomandimi:** DRT Tiranë, të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë konkrete dhe nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara në Tatimin mbi Fitimin, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse sipas anekseve dhe tabelave përkatëse pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

*Brenda 31.01.2019*

**1.2-Rekomandimi:** Sektori i Kontrollit nga Zyra pas verifikimeve paraprake të tatimpaguesve më sipër, për rastet specifike të klasifikuara evazion fiskal konform legjislacionit në fuqi, të bëjë propozimet përkatëse sektorit të kontrollit operacional në DRT për kryerjen e kontrollit të thelluar në vend për këta tatimpagues si dhe të përcjellë informacionin përkatës pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor Tiranë sipas rregullores së bashkëpunimit ndërmjet funksioneve të veçanta.

*Brenda 31.01.2019*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raport-kontrolleve të përzgjedhura u konstatua se, në 12 paktika kontrolli inspektorët e kontrollit nuk kanë zbatuar pikat e programit të kontrollit, duke kryer një kontroll formal në analizimin e tepricës kreditore të tvsh-së, në lidhje me klasifikimin e blerjeve. U konstatuan diferenca të konsiderueshme në bilancin material pothuajse në të gjitha praktikat e kontrollit të audituara ku në disa u vërejt se për data që ju përkasin viteve të mëparshëm analiza krahasuese e gjendjeve kryhej me inventar të cilësuar nga inspektorët në mënyrë të pakuptueshme si “inventar fizik” i cili për periudha të mëparshme efektivisht nuk mund të kryhet. Mungesa eidentohen në analizën krahasuese të treguesve vjetorë të TVSH-së në periudhat e mëparshme, koeficientëve të pagesës, normave të fitimit krahasuese et, Në disa prej praktikave konstatohen mungesa të nënshkrimeve sipas hierarkisë, të cilat janë të pargumentuara. Njoftimet e vlerësimit për rezultatet e kontrollit hartohen fillimisht manualisht nga inspektorët sipas llogaritjes së tyre, ndërkohë që sistemi C@ts pas ndërhyrjeve në sistem dhe kontabilizimit të raport-kontrollit, gjeneron njoftim vlerësimin automatik i cili i shkon tatimpaguesit në mënyrë elektronike. Kjo mënyrë veprimi krijon një dyzim të njoftim vlerësimeve në kundërshtim me nenin 69 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nuk janë trajtuar transaksionet me para në dorë (*Cash*) si dhe likuidimet e pagave nëpërmjet bankës sipas përcaktimeve në pikat n) dhe nj) të nenit 21, të Ligjit 8438 ”Për tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar. Mungon trajtimi i tatimit në burim, kontratave të qirasë si dhe mungesa e tyre në praktika sjell pamundësinë e një vlerësimi të saktë të zbatimit të VKM nr 469 datë 03.06.2015”Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”. Për sa më sipër nga auditimi i këtyre praktikave veç parregullsive procedurale janë konstatuar efekte financiare të cilat kanë ndikuar në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën prej rreth **327,118 mijë lekë**.

Të specifikuara sipas nipteve kemi këto efekte financiare:

1. **I.....**me NIPT L..... me efekt financiar prej 156,000 mijë lekë.
2. **S.....**me NIPT L..... me efekt financiar prej 8,277 mijë lekë.
3. **A.....** me NIPT K..... me efekt financiar prej 48,987 mijë lekë.
4. **A.....** me NIPT L..... me efekt financiar prej 27,932 mijë lekë.
5. **L.....** me NIPT K..... me efekt financiar prej 6,470 mijë lekë.
6. **S.....**me NIPT L..... me efekt financiar prej 13,841 mijë lekë.
7. **E .....**me NIPT K..... me efekt financiar prej 1,046 mijë lekë.

8. **L.....** me NIPT K..... me efekt financiar prej 4,597 mijë lekë.
9. **E.....** me NIPT L.....me efekt financiar prej 35,186 mijë lekë.
10. **L.....**me NIPT L.....me efekt financiar prej 3,814 mijë lekë.
11. **B.....** me NIPT K.....me një efekt financiar prej 2,235 mijë lekë.
12. **S.....** me NIPT L..... me një efekt financiar prej 18,823 mijë lekë.

*Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr.3 faqet nr. 47-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1- Rekomandimi:** DRT Tiranë, për 12 tatimpaguesit e cituar më sipër, për të cilët nga ana jonë janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit të cilat kanë ndikuar negativisht në buxhetin e shtetit në shumën rreth **327,118 mijë lekë**, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor sipas Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 85 i tij.

### ***Menjëherë***

**3.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, të paktën në 14 raste deklarata vjetore e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin (TFTH) për tatimpaguesit të cilat i përkasin fashës mbi 5 milion lekë përmban të dhëna të ndryshme përkatësisht në rubrikën nr. 8 *Të ardhura* e cila plotësohet me të ardhurat totale të periudhës tatimore si dhe rubrikën nr. 9 *Të ardhura tatimore* të cilat janë të ardhurat të cilat i përkasin aktivitetit të tatueshëm të formularit të deklarimit për vitin ushtrimor 2016 (16-A). Mungesa e verifikimeve dhe dokumentimi i diferencave përkatëse nga ana e administratës tatimore të DRT-Tiranë ka sjellë si rrjedhojë mungesë në llogaritjen e tatimit në masën 5% të diferencës midis këtyre rubrikave e cila kap vlerën **31,135 mijë lekë**. Në deklaratën TFTH 17-A konstatohen të paktën në 18 raste të tilla me një vlerë të pallogaritur për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e cila kap vlerën **36,341 mijë lekë**.

Për tatimpaguesit me përgjegjësinë e TFTH të regjistruar njëkohësisht edhe për përgjegjësinë e TVSH-së u krahasuan midis totalit të shitjeve vjetore të deklaruara në deklaratën e TVSH (fasha mbi 8 milion lekë) me deklaratën vjetore të TFTH nga ku rezulton mospërputhje në të paktën në 13 raste për vitin 2016 ku diferencat e konstatuara krijojnë efekte financiare të munguara në TFTH në shumën **4,624 mijë lekë**. Për vitin 2017 efekti financiar si rezultat i mospërputhjeve kap vlerën e **484 mijë lekë**. DRT Tiranë nuk rezulton të ketë ndërmarrë verifikimet e nevojshme për saktësimin nga zyra të situatës së tatimpaguesit dhe llogaritjen e detyrimit përkatës e cila mungon në regjistrat e njësisë publike. Po kështu për 39 tatimpagues nga ana e DRT Tiranë nuk janë përmbushur detyrimet funksionale për monitorimin e tatimpaguesit dhe ndryshimin e përgjegjësive në afat. Efektet financiare të munguara vetëm për rastet e mësipërm kapin shumën prej **72,584 mijë lekë**. *Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr.3 faqet nr. 47-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**3.1- Rekomandimi:** DRT Tiranë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të kryej verifikimet përkatëse dhe të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara në shumën prej **72,584 mijë lekë** për tatimpaguesit e cilësuar më sipër por jo vetëm.

***Brenda 31.01.2019***

**3.2- Rekomandimi:** Sektori i Analizës dhe Kontabilitet në bashkëpunim me Sektorin e Kontrollit nga Zyra, të analizojnë me hollësi treguesit e vetëdeklaruar të tatimpaguesve të regjistruar në tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe të propozojnë ndryshimin e përgjegjësive tatimore për tatimpaguesit të cilët plotësojnë kushtet për kalimin në TVSH dhe T.Fitimi përfshirë tatimpaguesit e trajtuar më sipër.

***Brenda 31.01.2019***

**4.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, për vitet 2016 dhe 2017 sipas deklaratës së Tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, evidentohen tatimpagues të cilët megjithëse e kanë kaluar kufirin

përcaktuar nga VKM nr. 953 datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014”, përgjegjësia tatimore e tyre nuk është ndryshuar në kundërshtim me përcaktimet e këtij vendimi por dhe të dispozitave të Ligjit 92/2014 Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, i ndryshuar neni 122 pika 1 e tij dhe UMF nr 6 datë 30.01.2015 “Për TVSH-në”, neni 5 pika 7 e tij ku përcaktohet se; *Detyrimet për TVSH-në për furnizimet (shitjet) e kryera për periudhat e mëparshme që ka qenë i detyruar të regjistrohej, i llogariten me efekt nga data kur ka qenë i detyruar të regjistrohej. Këto detyrime do të vlerësohen në regjistrin e TVSH-së në emër të personit të tatueshëm në periudhën e parë që ai regjistrohet për TVSH-në.* Për vitin 2016, tejkalimi i kufirit në shumën prej 106,259 mijë lekë ka sjellë si pasojë mungesën e llogaritjes nga ana e administratës tatimore të TVSH-së në masën 1/6 të vlerës së shitjes ose 17,710 mijë lekë mbështetur në UMF nr 6 datë 30.01.2015 “Për TVSH-në”, neni 30 pika 4 e tij. E njëjta situatë paraqitet në vitin 2017 ku tejkalimi i kufirit në shumën prej 108,815 mijë lekë ka sjellë si pasojë mungesën e llogaritjes së TVSH-së llogaritet në masën 1/6 të vlerës së shitjes ose 18,136 mijë lekë. Për tatimpaguesit me përgjegjësi (BV pa TVSH) me të ardhura tatimore të deklaruara më të mëdha se 8 milion lekë evidentuar nga ana jonë në Raportin Përfundimtar të Auditimit, veç mungesës së përgjegjësive të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar tatimpaguesve nuk u është shtuar dhe përgjegjësia e Tatimit mbi Fitimin, çka tregon për një mungesë të theksuar mbikëqyrje dhe monitorimi për tatimpaguesit nga ana e DRT Tiranë. Efekti total në mungesën e llogaritjes së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar llogaritet në vlerën e 35,846 mijë lekë. *Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr.3 faqet nr.47-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**4.1- Rekomandimi:** DRT Tiranë, pasi të kryejë verifikimet e nevojshme, të shtojë përgjegjësinë tatimore të TVSH-së për tatimpaguesit e përcaktuar më sipër si dhe të llogarisë TVSH-në e munguar në vlerën prej 35,846 mijë lekë, sipas përcaktimit të UMF nr.6 datë 30.01.2015, i ndryshuar.

*Menjëherë*

## **D. MASA DISIPLINORE**

**I.** Bazuar në gjetjet e evidentuara nga ana jonë në Raportin Përfundimtar të Auditimit, *i rekomandohet* Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve individuale për Titullarët e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë.

**II.** Mbështetur në nenet 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, *i rekomandohet*, Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për nëpunësit e poshtëshënuar të cilët në Raportin Përfundimtar të Auditimit janë ngarkuar me përgjegjësi individuale si vijon:

Masën **“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”** për punonjësit më poshtë:

1. G.G
2. D.V
3. E.G
4. S.S
5. D.A
6. E.Z
7. D.Q

8. H.M
9. A.T
10. Gj.D
11. A.C
12. E.G

Masën nga “Vërejtje” deri në “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për punonjësit më poshtë:

1. B.B
2. R.P
3. S.S
4. D.S
5. E.T
6. E.D
7. S.M
8. E.H
9. E.C
10. Q.D
11. S.M
12. L.K

**III.** Për punonjësit e tjerë përgjegjës, të Sektorit të Kontrollit nga Zyra në DRT-Tiranë, sipas shkeljeve të evidentuara nga ana jonë në Raportin Përfundimtar të Auditimit, *i rekomandohet* Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, që nëpërmjet Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve sipas përgjegjësisë individuale dhe të nisë menjëherë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, mbështetur në nenet 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

## **E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

## **F. TË TJERA**

*Në auditimin e radhës që do të zhvillohet nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit brenda vitit 2019, do të auditohet periudha e vitit ushtrimor 2018, me qëllim që të plotësohen të gjitha sugjerimet e Drejtorit të Përgjithshëm lidhur me përzgjedhjen e kampionit dhe garantimin e një*

*përfaqësimi të gjithë popullatës për përfitimin e një niveli të lartë sigurie bazuar në teknikat më të mira të auditimit dhe vlerësimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit të DRT Tiranë.*

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**